



Planuar / Doretuar Prenjura / Predato Approved / Delivory	14-06-2022	VITE год year	
Organ / Njësia Org / Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtesa Prilog Appendix	Qësia Kolicina Quantity
SKPM/HIC	3472/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.36/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi - Bajraktari dhe Jeton Koca - anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësi të procesmbajtëses për shqyrtimin e ankesës me numër rendor A.nr.36/2022 të datës 14.02.2020, të parashtruar nga ankuesi [redacted], sipas Aktgjykimit Anr.837/2020 të datës 17.05.2022 Gjykatës Themelore - Departamenti për Çështjen Administrative në Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokollit 10/2020 të datës 23.01.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP-së), në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 14.06.2022, mori këtë;

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa A.nr.36/2020 të datës 14.02.2020 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Institucionit të Avokatit të Popullit në pozitë Sekretari i Përgjithshëm, me datë 14.02.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 361/2020, kundër Vendimit me Nr. 10/2020 të datë 23.01.2020 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit, i cili vendim ka aprovuar ankesë e datës 25.11.2019 të ankuesit Arsim Agani nëpunës civil në pozitë Drejtor i Departamentit të Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me njohjen e përvojës së punës, duke e obliguar Divizionin e Burimeve Njerëzore të Institucionin të Avokatit të Popullit, që në afatin prej 15 ditësh, të shqyrtoj dokumentet noteriale të prezantuara nga ankuesi, sipas Vendimit Nr.67/2019 të datës 04.11.2019 të Komisionin për

Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, si dëshmi të përvojës së punës, bazuar në nenin 3 të paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.03.2022 ka përcjell kërkesën për përgjigje në ankesë, tek Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP-së), të cilën përgjigje Këshilli e ka pranuar me datë 25.02.2022, me shkresat e bashkangjitura prej 1/40 faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, dhe me datë 13.05.2020 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka njoftuar ankuesin lidhur me rrethanat e krijuar institucionale, me arsyetimin e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të vazhdojë me procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ, për të iniciuar procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, pasi ka pranuar Njoftimin e datës 13.05.2020 me numër protokollit 851/2020, ka parashtruar kërkesë padi me datë 14.05.2020 pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, duke iniciuar konflikt administrativ, e cila me datë 17.05.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër Anr.837/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 13.05.2020, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 14.02.2020 me numër protokollit 361/2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër Anr.837/2020 i datës 17.05.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Shkresa nga zyra e pranimit e datës 12.05.2020 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, bashkangjitur Padinë e datës 14.05.2020 nga ankuesi; Ankesën me numër protokollit 361/2020 të datës 14.02.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.10/2020 i datës 23.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit; Vendimi nr.06/29 i datës 15.05.2019; E-mail i datës 21.05.2015; Procesverbal i datës 25.05.2015; E-mail i datës 26.05.2015; Procesverbal i datës 08.07.2015; shkresë, kopje e lëshuar nga Noteri LRP Nr. rendor: 1770/2015; Kopje letërnjoftimi; shkresë, kopje e lëshuar nga Noteri Nr. rendor: 4931/2015; E-mail kërkesë e datës 14.07.2015; E-mail i datës 20.07.2015; Kërkesë për opinion e datës 24.06.2019 nr.42/2019; Opinion Ligjor nr.24/2019 i datës 06.08.2019; Vendim nr.181/2019 i datës 03.09.2019; Vendim i datës 04.11.2019; Vendim i datës 12.11.2019; E-mail i datës 02.03.2020; Përgjigje në ankesë e datës 12.03.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 10/2020 të datë 23.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit në bazë të të cilit është aprovuar ankesa e datës 25.11.2019 e ankuesit Arsim Agani i punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit të Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me njohjen e përvojës së punës.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi, duke konstatuar se me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative”*, ndërsa se kush konsiderohet palë në procedurën administrative Kolegji i u referuar nenit 14 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut. nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”*. Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimitimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: *“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim. Anëtar i një organi kolegjal, ka gjithashtu të drejtën të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi procedural të organit kolegjal, nëse pretendon se një nga dispozitat e neneve 37-43 të këtij Ligji janë shkelur nga një veprim apo mosveprim i tillë”*, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në këtë rast vlerëson se ankuesit me Vendimin me Nr. 10/2020 të datë 23.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Institucionin e Avokatit të Popullit nuk i janë cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, rrjedhimisht nuk ka legjitimitet për parashtrim të ankesës kundër këtij vendimi.

Bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrinë vetëm nëpunësit civil të cilëve i u janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, kështu që meqenëse ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të Kosovës nuk i plotëson kushtet për parashtrim të ankesës sipas nenit 124 paragrafi 1, nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë e njëjta konsiderohet se është pa pranueshme.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej

tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.36/2020


Rushit KAJATZI

Procesmbajtëse

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit


Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit 
- Udhëheqësit të Personelit në Institucionin e Avokatit të Popullit-IAP-së dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së .